



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

**Procesverbal i mbajtur më 22 nëntor 2023, në mbledhjen e XVI-të (gjashtëmbëdhjetë)-e jashtëzakonshme, mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë;  
(Naim Çunaku; Qëndrim softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Bashkim Syla; Mrika Thaçi, dhe Sebastina Vokri e cila arriti në përfundim të mbledhjes), bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishme ishin edhe; Xhevrie Beqiri-U.D. Drejtoresh e Drejtorisë së Administratës DA, dhe Saranda Stublla Drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ.

### Rendi i ditës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin ku mbledhja filloj me prezencën e 8 anëtarëve të KPF-së dhe gjatë mbledhjes prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit. Sot kemi mbledhjen e 17 të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbledhje kjo e cila është thirr si e jashtëzakonshme nga Kryetari i Komunës me të vetmin qëllim që disa prona të cilat menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të kthehen në pronësi të Komunës së Podujevës, pra pikë e rendi të ditës është:

- **Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa Pronave Shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP**

**Kryesuesi i Komitetit**, vazhdoi, pra i vetmi qëllim është që këto prona të kalojnë nga prona të menaxhuara prej Agjencisë Kosovare të Privatizimit në prona komunale. Sigurisht që Komuna ka nevojë për prona dhe për shkak të mungesës së pronave shumë projekte nuk mund të realizohen siç mund të jenë projekte për Shkolla, për Çerdhe, pastaj sigurisht jeni në dijeni për problemet që ka qyteti për varreza, kështu që është mirë që sa më shumë prona të AKP-së të kalojnë në prona komunale.

Urdhëroni për fjalë hyrëse në emër të ekzekutivit të Komunës.

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, pikë të rendit të ditë kemi Propozim vendimin për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa Pronave Shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Siç jemi në dijeni AKP para privatizimit të pronave e ka për obligim ta njoftoj Komunën lidhur me asetit e shitjes e që pastaj Komuna duke parë qëllimin e realizimit të projekteve i paraqet para Kuvendit të Komunës për shpallje në interes publik ato prona me qëllim të realizimit të projekteve.

Pra në propozim vendim janë të paraqitura disa prona në Zona të ndryshme kadastrale siç janë në Pakashicë të Poshtme, në Revuçë, në Bajqinë, në Surkish, në Dumnicë e Poshtme dhe në Zonën

kadastrale Podujevë ku është një lokal ish “Bankkos” i ish Ndërmarrjes Shoqërore, prandaj kërkoj nga ana Juaj që ta përkrahni këtë propozim vendim.

**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe diskutimet tona do t’i paraqesim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

**z.Haki Rudari**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së paraqet qëndrimin lidhur me këtë çështje apo kërkesë. Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim për shpallje në interes të përgjithshëm publik të disa pronave të cilat janë nën menaxhim të AKP-së, dhe mendojmë se qëllimi është në interes të qytetarëve respektivisht në funksion të realizimit të projekteve të ndryshme nëpër Drejtori të ndryshme, pra këtu janë të specifikuara edhe Drejtoritë se për çka janë funksionale këto prona për çka pajtohem që tri - katër Drejtori të cilat parashohin të kenë projekte e të cilat janë të specifikuara mendojmë që janë në interes të qytetarëve, andaj si Grup i LVV-së përkrahim këtë propozim vendim për shpallje në interes të përgjithshëm publik të këtyre pronave.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik dhe të njëjtin do ta mbështesim edhe në seancën e nesërme të Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim këtë propozim vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa pronave shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit që të njëjtat të kalojnë në prona komunale.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, mbështetet Propozim vendimi në fjalë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe njëkohësisht Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar për datën 23 nëntor 2023 .*

*Para se të përfundohet kjo mbledhje, Kryesuesi i Kuvendit dhe KPF-së i sqaroi të pranishmit lidhur me dërgimin e materialeve, përkatësisht telashet që po shfaqen lidhur me këtë çështje, me theks me e-maillet private të anëtarëve të Kuvendit ku në disa raste nuk pranohet kurse në disa raste pranohet 3-4 herë siç ishte për këtë mbledhje, prandaj ju kërkoj që t’i përdorni më shumë e-malet zyrtare sepse aty nuk paraqiten probleme të tilla.*

*Çështje kjo e cila i’u sqarua edhe anëtarit të Kuvendit z.Haki Rudari i cili e paraqiti si kërkesë që të vazhdohet me dërgimin e thirrjeve dhe materialeve ashtu siç ka qenë praktikë.*

*Kryesuesi i Kuvendit dhe KPF-së e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:20**

**Procesverbalin e mbajtën;  
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0083526/23  
Podujevë,  
22 nëntor 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit  
Hilmi Hoxha**